

***RENDI I DITËS***

**Shorti “Për caktimin e relatorit të kërkesave ankimore nr. 1, 2, 3, si dhe kërkesës nr. 1 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.**

**PJESËMARRJA :**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj , Z. E. Mema.**

**Z. Y. Merkaj:** Përshëndetje të gjithëve! Sot në datën 10 janar 2024, ora 11:04 zhvillohet seanca e shortit “Për caktimin e relatorit për tre kërkesa ankimore. Kërkesa ankimore nr. 1, kërkesa ankimore nr. 2 dhe kërkesa ankimore nr. 3, si dhe kërkesa e KSHZ nr. 1 “Për vendosje sanksioni administrativ”. Procedura e shortit për caktimin e relatorit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në katër janë shënuar tre kërkesat ankimore dhe kërkesa e KSHZ “Për vendosje të sanksionit administrativ”. Shiriti i pestë është i bardhë dhe pa shënime. Futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë transparente. Anëtarët e KAS-it nuk janë prezent në zhvillimin e seancës për caktimin e relatorit, kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së të tërheqë në emër dhe për llogari të tyre. I vendosim shiritat me kërkesat ankimore nr. 1, nr. 2, nr. 3 si dhe kërkesën e KSHZ, në fund vendosim dhe shiritin e bardhë dhe pa shënime. I vendosim në enën transparente. Pasi përziejehen nga një përfaqësues i KQZ-së, duke filluar me rendin alfabetik rritës

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

**Zotit Elvin Lako:** – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

**Zotit Elvis Çefa:** – Kërkesa e KSHZ.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.10.01.2024*

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

**Zotit Ilirjan Rusmali:** – Kërkesa ankimore nr. 2.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

**Zotit Koli Bele:** – Kërkesa ankimore nr. 1.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të:

**Zotit Ledio Braho:** – Kërkesa ankimore nr. 3.

Në përfundim të procedurës së shortit:

Relator i kërkesës ankimore nr.1 është zoti Koli Bele.

Relator i kërkesës ankimore nr. 2 është zoti Ilirjan Rusmali.

Relator i kërkesës ankimore nr. 3 është zoti Ledio Braho dhe,

Relator i kërkesës nr. 1 të KSHZ “Për vendosje sanksioni administrativ” është zoti  
Elvis Çefa. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

